



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

Nr. 603 Prot.

Ballsh, më 27/12 .2024

NJOFTIM

Konsultim Publik me temë: “Strategjia vendore për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2024 – 2030”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 18 dhe neni 52, ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit Publik”, Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike, si dhe duke u nisur nga kërkesa e Drejtorisë së Mbrojtjes civile dhe Territorit për realizimin e konsultimit publik me temë: “Strategjia vendore për Reduktimin e Riskut nga fatkeqësitë 2024 – 2030” për Bashkinë Mallakastër,

Ditën e Martë më datë 21.01.2025, ora 10⁰⁰, në ambientet e sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Mallakastër, do të organizohet konsultimi publik me përfaqësues të komunitetit, kryetarët e fshatrave, kryetarë të njësive administrative, anëtarë të këshillit bashkiak, përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesi, dëgjuesë publike me temë: “Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”.

Ftojme të gjithë të interesuarit, të gjejnë në linkun e mëposhtëm draft dokumentin që do të konsultohet në datën 21.01.2025, me qëllim që të bëni komente dhe sugjerime konkrete në ditën e konsultimit publik.

<https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sq/njoftime/strategjia-vendore-p%C3%ABr-zrf-2024-2030bashkia-mallakaster>

Komentet të dërgohen në adresat e mëposhtme të emailit:

ballshi@bashkiamallakaster.gov.al, rosmenaj@bashkiamallakaster.gov.al dhe zahmetaj@bashkiamallakaster.gov.al

KRYETAR

Qerim Ismailaj

